



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 17/18
Prishtinë, më 23.02.2018, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Blerim Kuqi, Mërgim Lushtaku, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Lulzim Rafuna - Kabineti i Ministrisë së Financave, Avni Jashari - Zëvendës drejtor menaxhues në AKP.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Nita Latifi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtur më 07.02.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080;**
- 4. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 07.02.2018

Kryetari konstatoi se komisioni unanimisht miratoi procesverbalin, e mbledhjes së mbajtur më 07.02.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080

Kryetari theksoi se si grup punues e kemi shqyrtuar projektligjin dhe në takim kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të AKP-së, të cilët kanë dhënë sqarime për secilën pikë të cilën e kemi shqyrtuar. Ju e keni marrë raportin me amendamentet të cilat i kemi propozuar si grup punues dhe janë gjithsej 18 amendamente, ndërsa 12 amendamente janë të propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe që nuk i kemi përkrahur. Në amendamentin 4, ka një propozim për ndryshim, dhe aty ku thuhet se AKP e njofton Ministrinë e Financave, dhe Ministria e Financave i kthen mjetet AKP-së, të bëhet Qeveria. Si dhe ndryshimin që kemi bërë se mjetet e privatizimit përdoren për financimin e investimeve me efekt të drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit, të shtohet fjala, afatgjatë. Pra, të thuhet se mjetet përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se nuk keni vërejtje, propozojë që amendamentet të miratojë në grup, pa amendamentin 16 që ka mbetur të shqyrtohet në komision.

Kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, dy Abstenime dhe asnjë Kundër, miratoi njëzëri 17 amendamente të propozuara nga grupi punues. Si dhe nuk përkrahu 12 amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar Lista Serbe.

Kryetari tha se sa i përket amendamentit 16 që ka të bëjë me vazhdimin e mandatit të anëtarëve aktual të bordit edhe për një vit, nga tre në katër vite, ashtu siç parashihet me këtë ligj, mandati i anëtarëve të rinj të bordit që do të emërohen. Ne kemi kërkuar interpretim prej zyrës ligjore dhe nuk ka praktikë që Kuvendi t'ia zgjatë mandatin aktual bordit, kështu që unë nuk kam guxuar që të marrë një vendim të tillë që nuk ka mbështetje ligjore.

Naser Osmani tha se sipas ligjit bazik, ka qenë e ndarë që kryetari dhe zëvendëskryetari me pas për një vit mandat ma shumë se sa anëtarët e tjerë të bordit. Mendimi im është që një mandat katërvjeçar në një institucion ku ka tjetërsim të pronave është majft delikate dhe unë mendojë që ishte dashur me e shkurtuar, me e bërë për të gjithë anëtarët dhe kryetarin të jetë tri vjet, me të drejtë të rizgjedhjes edhe njëherë.

Kryetari: Propozimi i zotit Osmani është me kufizuar mandatin për tri apo katër vjet, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. A ka dikush me shtuar diçka sa i përket këtij propozimi?

Dardan Molliqaj pyeti pjesëmarrësit e ftuar në takim, cila është logjika apo arsyeimi për me bërë mandatin tri apo katër vjet?

Avni Jashari theksoi se në bazë të ligjit në fuqi, kryetari dhe zëvendës-kryetari i bordit që zgjidhet prej bordit e kanë mandat tri vjet, ndërsa anëtarët e bordit dy vjet. Praktika jonë në tetë vitet e kaluara ka treguar se mandati dyvjeçar i anëtarëve të bordit nuk është i mjaftueshëm për shkak se shkon një periudhë e caktuar deri sa të familjarizohen me të gjitha proceset që janë në punën e institucionit, dhe kjo ka qenë edhe arsyeja pse është propozuar mandati katërvjeçar. Ndërrimi i shpeshtë i anëtarëve të bordit, çdo dy vjet nuk ka qenë një praktikë shumë e mirë, sepse kryetari dhe zëvendëskryetari kanë mandatin tri vjet, të tjerët dy vjet, dhe kemi mbetur pa bord funksional.

Blerim Kuçi theksoi se nuk e di që ka ndonjë praktikë që një mandat për institucionet e tilla është dy vjet. Pse duhet me u ndryshuar AKP-ja prej agjencive të tjera apo prej ndërmarrjeve publike. Dy vjet është shumë pak dhe dy vjet shkojnë derisa ata të ambientohen me punën. Sa a duhet të jetë tri apo katër

vjet mund të diskutohet. Por, unë mendoj se duhet mbetur katër vjet, duke pasur parasysh edhe vonesat në procedurën e zgjedhjes së tyre në Kuvend.

Dardan Molliqaj: Për mua nuk është argument i qëndrueshëm caktimi i mandatit për tre apo katër vjet me arsyetimin se kërkohet një kohë për t'u ambientuar me punën. Nuk ka kuptim me shkuar në bord, e me kaluar një muaj e mos me kuptuar se çfarë je duke bërë. Ne nuk duhet aty për me i dërguar njerëzit për me mësuar. Për mua argument kishte me qenë në qoftë se kishin me thënë që agjencia bënte planifikime trevjeçare apo katërvjeçare.

Kryetari: Kam një pyetje për ju zotëri Jashari, sipas vlerësimit tuaj, a përfundon misioni i AKP-së në gjashtë vitet e ardhshme?

Avni Jashari theksoi se në shtator të vitit 2016 bordi i agjencisë e ka punuar një strategji për përmbylljen e proceseve brenda shtatë vjetëve. Ajo strategji është diskutuar në komisionin për zhvillim ekonomik dhe ka mbetur pastaj me u diskutuar në njërën prej seancave të Kuvendit, për me përcaktuar një mandat jo në ligje, por me vendim të Kuvendit. Kanë mbetur edhe me shumë se gjysma e aseteve pa u shitur, aktualisht janë 23 mijë lëndë në shqyrtim gjyqësor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Dhoma e Posaçme i trajton përafërsisht rreth 2400 lëndë në vit, mirëpo vetëm trajtimi i lëndëve në Dhomën e Posaçme merr rreth 10 vjet. Kjo nuk do të thotë që agjencia duhet me ekzistuar edhe 10 vjet në mandatin aktual, mbasë një kohe të caktuar ne duhet të bëjmë edhe rishikimin e stafit të cilët janë aktual, por trajtimi i shitjes së aseteve ishte dashtë me u përfunduar në periudhën rreth 4 apo 5 vjeçare. Normalisht që një bërthamë e zyrtarëve do të mbesin dhe do të transferohen në një institucion apo si organ në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ose Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që të merren me çështje gjyqësore, mirëpo është e pamundshme që puna e agjencisë të përfundojë për tri apo katër vjet. Planet tona janë për gjashtë vjet.

Lulzim Rafuna theksoi se ne prej Ministrisë së Financave e kemi pasur parasysh që mos me pezulluar puna dhe për këtë arsye kemi shkuar me dy propozime të pozitive të bordit. E para është që mos me pasur vakum bordi aktual dhe të mos iu përfundojë mandati deri në zgjedhjen e bordit të ardhshëm. E dyta ne kemi pasur parasysh faktin se shumica absolute e bordeve i kanë mandatet katërvjeçare dhe ne kemi menduar që është reale dhe shumë i drejtë për stabilitetin e AKP-së me e pas mandatin si shumica e agjencive të tjera katër vjet.

Safete Hadërgjonaj: Të thënë të drejtën sa herë ne që flasim për këto borde, si në tension jam dhe duke parë punën e këtyre bordeve që e bëjnë, me pasur mundësi i kisha hequr krejt këto borde në të gjitha institucionet dhe ju kishim lënë me funksionu me kryeshefa ekzekutiv. Sa i përket mandatit të anëtarëve të bordit të AKP-së, unë e përkrahu mendimin e Naserit për me pasur mandat trevjeçar dhe po me duket që ka qenë jo mirë e rregulluar mandati 2 plus 1. Prandaj, duke marrë parasysh që është një agjenci mjaft e ndishme dhe me një punë që duhet bërë shumë serioze, aty ndoshta është e nevojshme një mandat 3 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjes edhe për një mandat.

Enver Hoti: Unë mendoj që ma mirë me qenë mandati katër vjet, që mos me pas dallime në mes anëtarëve të bordit, që dikush 2 vjet e dikush 1 vit. Sa i përket çështjes tjetër që t'iu vazhdohet mandati me ligj deri sa të zgjedhen anëtarët e rinj. Unë nuk e di pse duhet me ardhur në atë gjendje që mos me u përzgjedhur me kohë bordi apo doni me shkuar drejt tendencës që me e lënë njëfarë pshtjellimi ligjor që me kaluar në gjendjen e ushtruesve të detyrës, sikurse qysh i kemi nëpër institucione nga katër apo pesë vjet.

Ali Lajçi: Sa i përket mandatit, unë mendoj se duhet të jetë katër vjet dhe le të barazohet në kuptim të mandateve të institucioneve të tjera, duke pasur parasysh edhe procedurat që kanë me zgjatur dy vjet

deri sa të stabilizohen në punë, dhe në këtë mënyrë mund të kemi mundësi të jenë për punë ma stabile dhe ma produktive.

Naser Osmani tha se praktika sjell situatë të ndryshme. Ne kemi pasur raste që për shkak të zgjedhjeve, të zhvillimeve politike, shumë institucione kanë mbetur pa borde dhe nuk kanë mundur me funksionuar dhe një rast i tillë ka qenë në Trustin Pensional. Prandaj, unë konsideroj që një mandat trevjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe njëherë është i mjaftueshëm, sepse këta janë anëtarë të bordit që shkojnë vetëm një herë në muaj në mbledhje. Kur ta kalojnë periudha gjashtëvjeçare e aprovimit të strategjisë në përsëri duhet me e ndryshuar ligjin për me e vendosur se çka më tutje me këtë pjesën e aseteve që kanë mbetur prej procesit të likuidimit të pashitur. Dikush duhet me marrë atë përgjegjësi sepse procesi në Gjykatë ka me shkuar jo dhjetë vjet, po unë garantoj që edhe 20 vjet, sepse ka me pasur ankesa prej të gjithë atyre pretenduesve që i kanë konsideruar si pronë të veten.

Mërgim Lushtaku theksoi se çështja që po diskutohet për mandatet katërvjeçar, dhe unë mendoj që është një llojë fondi ose një llojë agjencie në kuadër të një institucioni të rëndësishëm, që një obligim të madh për shtetin e Kosovës. Unë besoj që është mirë të jetë katërvjeçar. U tha se kemi institucione dhe ndërmarrje që mandati është me tri apo katër vjet, por unë besojë nëse dëshirojmë një politikë afatgjate, një mandat katërvjeçar ndikon në plotësimin e objektivave në një institucion të caktuar.

U përmend edhe aspekti i familjarizimit në këtë ndërmarrje ose edhe në agjenci të tjera, nëse dëshiron me vepruar keq nuk është e domosdoshme me pasur edhe dy, tri apo katër vjet mandatin, ata munden në fillim të mandatit me menduar dhe me vepruar keq, kështu që nuk është një arsyetim pse me qenë dy, tre apo katër vjet. Ne duhet të jemi të kujdesshëm që të plotësohen kriteret e përzgjedhjes që të jenë kredibile dhe të mos ketë ndonjë vepër penale.

Vazhdimi i mandatit si pasojë e moszgjedhjes së bordit është shumë e domosdoshme në këto rrethana ku jetojmë, e dimë që ka raste edhe të tjera që kanë qenë edhe në zgjedhje parlamentare, ku ka pasur edhe vakum institucional, kemi pasur ngërqe politike për shkak të mosformimit të Qeverisë, siç është rasti edhe me KPMM, ku për shkak të skadimit të mandatit të anëtarëve të bordit dhe moszgjedhjes së të rinjve, nuk ka mundur me iu dhënë licenca bizneseve, që ka ndikuar në faktorizim dhe neglizhencë të sektorit privat.

Ndoshta është edhe mirë me formuluar një amendament që me rastin moszgjedhjes së bordit, nuk është e domosdoshme që t'iu vazhdohe automatikisht mandati edhe katër vjet, por me rastin e zgjedhjes së bordit të rinj, bordit të vjetër automatikisht iu ndërprehet mandati.

Kryetari konstatoi se komisioni me shumicë votash, vendosi që mandati i anëtarëve të bordit që do të zgjidhen pas miratimit të këtij ligji, të mbetetë katërvjeçar.

Kryetari: Çështje tjetër se me nenin 9 të këtij projektligji thuhet se mandati i anëtarëve të rinj do të jetë katërvjeçar, ndërsa me nenin 16, po themi që ky neni 9 vlen edhe për anëtarët që janë në detyrë. Ne, si grup punues, e kemi refuzuar sepse nuk ka precedent të tillë të vazhdimin të mandatit me ligj të anëtarëve aktual që janë në bord.

Dardan Molliqaj: Theksoi se anëtarët aktual të bordit e kanë marrë një mandatë në bazë të një ligji ekzistues dhe ligji i ri që bëhet tash nëse kalon vlen për mandatin e ardhshëm dhe nuk ka kuptim që në mënyrë retroaktive me iu vazhduar mandati edhe një vit.

Naser Osmani: Nëse shkon kështu qysh po thotë deputeti atëherë ne nuk do të mundemi ta bëjmë bordin me mandat të plotë sepse gjithmonë ka me munguar dikush.

Dardan Molliqaj: Ju po dëshironi që me i pasur gjithmonë katër vjet dhe të fillojnë të gjithë me mandat dhe ta përfundojnë njëjtë, jo domosdoshmërisht mund të ndodhë që të zgjidhen përnjëherë. Mund të

ndodhë ndonjë anëtar të japë dorëheqje, të vdesë apo të shkarkohet, kështu që kërkesa që t'i barazojmë nuk ka ndonjë vlerë konceptuale e as praktike.

Avni Jashari: Në qoftë se kryesuesit i skadon mandati, atëherë anëtarët e tjerë nuk kanë pse me u mbledhur pa kryesuesin. Ne e kemi parë se qysh kanë qenë mandatet dy dhe tre vjet, ndërsa tash po dëshirojmë me i bërë me mandate të rregulltë që me qenë sa ma efikasë Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe mos me pasur shprehjetje.

Enver Hoti: Me të vërtetë është pak e pakuptueshme ky propozimi i Qeverisë për me i barazuar gjërat dhe kështu nuk barazohen. E tha edhe zotëri Molliqaj shumë mirë, ne gjithmonë dhe vazhdimisht kemi plotësime të bordeve të ndërmarrjeve të tjera. Prandaj, unë propozoj me e hequr këtë pjesën që është këtu te neni 16.

Kryetari: Unë po propozoj për me e fshirë nenin 16, sepse nuk mundemi me i barazuar në mandat, anëtarët aktual dhe atë që do të zgjidhen.

Safete Hadërgjonaj – Ne kemi pasur rastin e zgjedhjeve dhe për shkak të situatës së krijuar politike dhe mungesës së institucioneve nuk ka pasur mundësi me u zgjedhur anëtarët e bordit, dhe punën e Agjencisë së Privatizimit ka mbetur e bllokuar sepse nuk ka pasur bord për me marrë vendime, ndërsa ligji thotë që vendimet duhet me i marrë bordi. Ne kemi pasur përvojë të keqe nga e kaluara pikërisht për shkak të zgjedhjeve se në kushte normale zgjidhen me kohë dhe nuk ka problem.

Kryetari theksoi se ne kemi rastin të Trustit Pensional, ku në bazë të ligjit, anëtarëve të bordit iu vazhdohet mandati me ligj edhe pas skadimit të tyre për tre muaj, nëse nuk zgjidhen anëtarët e rinj me kohë, por jo më shumë se tre muaj.

Naser Osmani: Praktika ka treguar që AKP ka mbetur nëntë muaj pa bord për shkak të neglizhencës politike. Prandaj, propozimi i ngjashëm me Trustin Pensional ndoshta mund të aplikohet edhe në këtë rast, që t'iu vazhdohet mandati edhe për tre muaj, por kjo nuk do të thotë se mund të qëndrojnë tre muaj në detyrë në rast Qeveria dhe Kuvend arrijnë të bëjnë zgjedhjen e tyre me kohë. Është rasti të Buxheti i Kosovës i cili aplikohet 2 plus 1 muaj në rast se nuk miratohet buxheti i ri para fillimit të vitit fiskal.

Mërgim Lushtaku – Ne gjithë kemi mendime të ndryshme me u zhgjedhur kjo problematikë. Por unë vetë kam qenë pjesë e grupit punues për Projektligjin Administratës Shtetore dhe ndër të tjera është diskutuar edhe çështja e vakumit institucione kur kemi zgjedhje apo edhe ndonjëherë neglizhencë kryesisht prej politikës dhe ndikimi që po ka kjo situatë në moszgjedhjen e anëtarëve të bordeve për arsye të rrethanave politike. Projektligji do të del së shpejti në qeveri për miratim e pastaj në Kuvend, dhe në këtë frymë unë besoj se mundemi me vendos që me iu vazhduar mandati jo i kufizuar në muaj, por deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj.

Dardan Molliqaj tha se nuk ka kuptim këto praktika për vazhdimin e mandatit pas skadimit të tyre. Ajo që qenka rregulluar për Trustin Pensional, për mua është gabim dhe mandati duhet të jetë i plotë dhe pas skadimit të tij, anëtarë përfundon funksionin.

Mërgim Lushtaku theksoi se nuk është e vërtetë se veç ne i kemi këto praktika, dhe ka praktika evropiane se si i bëjnë rregullimet e tilla të mandatit dhe nëse kemi interes ne mund edhe të kërkojmë hulumtim për të parë se si i kanë të rregulluar këto çështje.

Dardan Molliqaj tha se nuk është çështja a është praktikë ligjore, por çështja është te logjika e manaxhimit institucional. Mandate e kufizuara e kanë logjikën zhvillimore dhe menaxhuese. Ne çfarë po

duam të bëjmë tani është se si me menaxhuar situta në paraqitjen e krizave të mundshme politike. Ligji nuk ish dashur t'i rregullojë këto çështje, për arsye se kur shpallet gjendja e jashtëzakonshme suspendohen shumë ligje dhe aplikohen rregulla të caktuara.

Avni Jashari theksoi se për arsye objektive, dy herë ka ndodhur që agjencia me mbetur pa bord dhe është jashtëzakonisht e vështirë me funksionuar agjencia pa bord, pasi që vendimet kryesore merren në bord, si shitja e asetëve të ndërmarrja, aprovimi i listave të punetorëve dhe nëse nuk ka bord nuk mundemi me bë administrimin direkt të një ndërmarrje.

Kryetari konstatoi se pas diskutimeve dhe propozimeve, komisioni unanimisht vendosi që të fshihet neni 16 i projektligjit dhe si rrjedhojë anëtarëve të bordit të AKP-së, që iu skadon mandati, iu ndërpritet menjëherë. Po ashtu, kryetari, konstatoi se komisioni vendosi që Raportin me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080, të procedojë për shqyrtim në komisionet e tjera të përhershme.

4. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale

Kryetari sqaroi se komisionet e tjera të përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe amendamentet që kemi propozuar si Komision Funkcional dhe nuk kanë bërë ndonjë vërejtje dhe tani për shkak të procedurë kërkohet një votim formal që raportin me rekomandime ta procedojmë për shqyrtim në Kuvend.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, miratoi Raportin me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, dhe të njëjtin e procedoi për shqyrtim të dytë në Kuvend.

5. Të ndryshme

Ali Lajçi – Ne kemi diskutuar në komision çështjen e vendodhjes së institucioneve në objekte me qira dhe kemi vendosur që të thërrasim Ministrin e Administratës Publike për raportim, dhe më intereson të dijë çfarë është bërë deri më tani. Çështja e dytë, ka të bëjë vendimin për anulimin e shtesave dhe kompensimeve të bordit të KOSTT-it, se i është dërguar komisionit?

Kryetari – Sa i përket temës së objekteve të institucioneve të vendosura me qira, ne kemi planifikuar në plan të punës që për çështje ta ftojme në raportim Ministrinë e Administratës Publike në muajin mars dhe do ta ftojme në një mbledhje të posaçme. Sa i përket kërkesës së komisionit që Bordi i KOSTT-it me anuluar vendimin për kompensimin e shtesave për anëtarët e bordit. Unë i kam kërkuar bordit që të dërgojë me shkrim vendimin apo njoftimin për anulim dhe më kanë thënë se në mbledhjen e radhës do ta shfuqizojnë vendimin e tillë dhe do ta njoftojnë komisionin.

Një çështje tjetër që kemi planifikuar edhe në planin e punës është çështja e kartonit të gjelbërt dhe nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të bërë këtë të mundur. Unë propozoj të formojmë një grup punues që do të merret direkt me këtë çështje, të organizohen dëgjimet publike me aktorët relevantë dhe propozoj që në grup punues të jenë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani dhe Blerim Kuçi.

Kryetari konstatoi se komisioni të themelojë Grupn Punues për hartimin e Propozim-Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në këtë përbërje: Lumir Abdixhiku (kryesues), Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani dhe Blerim Kuçi. Grupi i

punës, përgadit Propozim-Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, për shqyrtim në Komision.

Safete Hadërgjonaj theksoi se në planin e punues kemi caktuar që të monitorojmë dy ligje. Në pjesën e parë të vitit kemi vendosur të monitorojmë Ligjin për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, dhe propozojë që të formojmë një grup punues që të fillojë punën e monitorimit dhe pastaj të përgatitet raporti me rekomandime për komision dhe Kuvend.

Kryetari propozoi që në Grupin Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare Financiare Jobankare, të jenë: Safete Hadërgjonaj (kryesuese) Enver Hoti dhe Ali Lajçi.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht formojë Grupin Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me këtë përbërje: Safete Hadërgjonaj, kryesuese, Enver Hoti, dhe Ali Lajçi. Grupi punues e paraqet Raportin me rekomandime për shqyrtim në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 16:15.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku